REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2019:116962
Datë:	23.12.2019
Numri i dokumentit:	00729640

C.nr.76/19

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional Adem Krasniqi, në kontestin e paditësit A.K, nga Prizreni, me banim në rrugën "...", nr. ..., të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat Sh.B, nga Prizreni, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm Prim. Dr. "..." - Prizren, të cilën e përfaqëson i autorizuari B.Sh, nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimin e një page jubilare, me datën 18.12.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A.K, nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Spitali i Përgjithshëm Prim. Dr. "..." - Prizren, që paditësit në emër të (1) një page jubilare t'ia kompensojë paditësit shumën prej 413,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri ne ditën e pagesës definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 320,00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi A.K, nga Prizreni, përmes të autorizuarit avokat Sh.B, nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim.Dr...." nga Prizreni, në të cilën ka deklaruar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, prej nga është pensionuar me stazh më shumë se 10 vite punë. Me vendimin e Drejtorit të Spitalit Rajonal "Prim.Dr...." në Prizren, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit). Pas pensionimit me kërkesë i është drejtuar të paditurës, që në emër të pagave jubilare për pension, konform nenit 52 të kontratës kolektive të vitit 2015 t'ia paguajë të njëjtat pas shkuarjes në pension. Mirëpo, e paditura në përgjigjen e saj ia ka refuzuar kërkesën paditësit për pagesën e këtyre pagave. Andaj, i është drejtuar kësaj gjykate, nga e cila ka kërkuar që kërkesëpadinë e tij ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ku ka kërkuar kompenzimin e një page jubilare shumën prej 413,00 euro.

2019:116963

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit av. Sh.B, nga Prizreni, ka mbetur në tërësi sikurse në padi dhe në kërkesëpadi, dhe gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar, pasi që e njëjta është e bazuar në ligj dhe në MPKK-në, dhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

Përmes përgjigjes në padi e paditura ka theksuar se e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit sa i përket pagave jubilare, duke shtuar se me dispozitat e nenit 52 të MPKK-së, është paraparë se i punësuari ka të drejtë në shpërblime jubilare dhe atë pas mbushjes së vitit jubilar 10, 20 apo 30 vjet të provojes së punës pa ndërprerë tek punëdhënësi i fundit në 1, 2 apo 3 pagave jubilare, ndërsa në paragrafin 3 të po këtij neni është paraparë se këto shpërblime paguhen në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushtit të cekur më lart. Ajo shtoj se nga ky konstatim mund të kuptojmë se shpërblime jubilare paguhen në afat prej 1 muaj prej ditës kur i punësuari i mbush 10, 20 apo 30 vjet, apo të ashtuquajturit vit jubilar. Sipas saj, paditësi tek e paditura është punësuar më 11.11.2002, dhe se mund të konstatohet se vitin jubilar, apo 30 vjet provoj pune i ka mbushur më 30.07.2014, dhe se ky vit për të është viti jubilar. Nga kjo, siç ka cekur i autorizuari i të paditurës, në atë kohë MPKK nuk ishte në fuqi dhe se e njëjta nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, andaj edhe këtu paditësit nuk i takon e drejta në këto shpërblime jubilare, ngase sipas ligjit të punës me nr. 03/L-212, neni 87, ku thuhet se të gjitha kërkesat nga marrdhënia e punës në para, parashkruhen në afatin prej tri vitesh.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata me propozimin e palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova; bëhet leximi i librezës së punës në emër të A.(A).K; bëhet leximi i përgjigjes në kërkesë me nr.... të datës 10.01.2019; bëhet leximi i vendimit të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Prizren me numës amzë 765 të datës 20.11.2015; bëhet leximi i historisë bankare lëshuar nga Banka Ekonomike, me datë 27.12.2018; bëhet leximi i vërtetimit të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Prizren me numër 13/80 të datës 17.04.2019.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Nga leximi i librezës së punës në emër të A.(A).K, gjykata ka konstatuar se paditësi, ka qenë në marrdhënie pune në Spitalin i Përgjithshëm, Prim. Dr. "..." - Prizren, nga data 11.11.2002 deri më datë 23.11.2015. Ndërsa paraprakisht ka qenë në marrdhënie pune dhe atë nga data 24.06.1971 deri më datë 28.11.1972, në Fabrikën e Tekstilit- .... Nga data 07.12.1974 deri më datë 02.09.1980 ka punuar në ndërmarrjen .... Ndërsa nga data 03.09.1980 deri më datë 19.06.1984 ka qenë në marrdhënie pune ka qenë në marrdhënie pune në Organizatën ndërtimore- .... Ndërsa nga data 20.06.1984 deri më datë 28.10.1991 ka qenë në marrdhënie pune në Gjimnazin në Prizren, dhe i njëjti ka gjithsej përvojë pune 31 vite 3 muaj e 24 ditë.

Nga leximi i përgjigjes në kërkesë me nr.6/2 të datës 10.01.2019, gjykata ka konstatuar se palës paditëse i është refuzuar kërkesa për kompenzimin e pagës jubilare.

Nga leximi i vendimit të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Prizren me numës amzë 765 të datës 20.11.2015, gjykata ka konstatuar se paditësi me vendimin e të paditurës i

ndërprerë marrdhënia e punës me datë 23.11.2015, për shkak se i padituri e ka arritur moshën e pensionimit 65 vjeç.

Nga leximi i historisë bankare lëshuar nga Banka ..., me datë 27.12.2018, gjykata ka mësuar se paga bazë e paditësit që tre muajt e fundit ka qenë 413.28 euro.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Prizren me numër 13/80 të datës 17.04.2019, gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrdhënie pune tek i padituri nga data 11.11.2002 deri më datë 23.11.2015, ku edhe është pensionuar.

Në nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit parashihet se "*Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj**".*** Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se *"1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4.* ***kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeq".*** Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *"1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.*
6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj".

Po ashtu në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, parashihet se: "I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *"Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilare*" dhe se paragrafi 3 i këtij neni parasheh se "*Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragrafi*".

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë i caktuar në vendin e punës tek Spitali i Përgjithshëm, Prim. Dr. "..." - Prizren, të njëjtit, iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit).

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë deri më 23.11.2015, kur të njëjtit me vendim të të paditurës i është ndërprerë kontrata e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit. Paditësi në procedurën administrative i është drejtuar të paditurës me kërkesë që e njëjta ti paguaj pagat jubilare, prej së cilës ka marr përgjigjen me të cilën i është refuzuar kërkesa e tij, andaj paditësi i është drejtuar me padi gjykatës për realizimin e të drejtave të tij. Kjo është

vërtetuar në bazë të provave të administruara e sidomos (vendimit për pensionimin e këtu paditësit dhe përgjigjes së të padituës në kërkesën e paditësit). Në rastin konkret gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje juridike vlerësoi dispozitat ligjore të cekura në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ku në neni 3 është paraparë se "*dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës",* ndërsa në nenin 4 është paraparë se *"dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit të cilët në çfarëdo mënyre kryejnë veprimtari ekonomike, jo ekonomike dhe shërbime civile.* Po ashtu në nenin 52 të kësaj kontrate është paraparë se "*I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij".*

Andaj, provave të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pretendimet e palës së paditur të cekura në përgjigje në padi se në rastin konkret paditëses nuk i takon e drejta në shpërblime jubilare pasi që vitin e jubileut të 30 këtu paditësja e ka pasur në vitin 2011, i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se neni 52 i MPKK-së, ndër të tjera ka paraparë se *"...te punëdhënësi i fundit...*", gjë nga e cila mund të kuptojmë se i punësuari të drejtën në shpërblime jubilare i takon pas arritjes së moshës së pensionimit, jo edhe më herët apo në momenti e mbushjes së vitit jubilar. Sipas gjykatës nga formulimi i këtillë i kësaj dispozite pa dyshim se i punësuari të drejtën e pagesës së pagave jubilare e fiton në momentin e pensionimit, gjë të cilën paditësi tani më e ka arritur. Ndërsa sa i përket pretendimet të paditëses se pagat jubilare paguhen brenda afatit prej 1 muaj nga momenti i plotësimit të kushteve, gjykata është e qëndrimit se ky afat vlen pikërisht për të padituën, e cila pasi që të plotësohet kushtet ligjore brenda këtij afati është e obliguar ti paguaj të punësuarit një shumë të tillë, dhe në rastin konkret e drejta e paditësit për të kërkuar kompenzimin e pagave jubilare pas pensionimit, për paditësin është krijuar pas arritjes së moshës së pensionimit.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësit në kuptim të dispozitave të lartëcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë tërësisht si të bazuar dhe e detyroi të padituën që paditësit t'ia paguajë një pagë jubilare, pasi që i njëjti në bazë të librezës së punës (të cilën gjykata e ka administruar si provë) ka provoj të punës më shumë se 30 vite, dhe dispozitat MPKK-së, decidivisht parashohin se këto paga i paguan "*punëdhënësi i fundit*", e cila në rastin konkret është këtu e paditura, e që në rastit konkret gjykata duke vepruar brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e pagave të cilën paditësi e ka realizuar në tre muajt e fundit para pensionimit, mori parasysh historinë bankare lëshuar nga Banka Ekonomike, ku konstatohet se paditësi për tre muajt e fundit ka realizuar të ardhura me pagë mujore prej 413.28 euro.

Për detyrimin e të padituës për të paguar kamatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 382 par.2 i LMD-së, meqenëse e paditura është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 të LPK-së.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr. 76/2019 datë 18.12.2019

B.Profesional **Gjyqtarja**
Adem Krasniqi **Edije Sezairi**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.